



*KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a

APLIKIMI TARIFOR PËR VITIN 2012

Pjesa IV-Aplikimi Tarifor për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes

12 janar, 2012

Përmbajtja

I.	Hyrje	3
A.	Përmbledhje.....	3
B.	Bilanci i Energjisë	3
C.	Definicionet.....	4
II.	Rregullat e Çmimeve dhe Metodologjia e Tarifave	5
A.	Rregulla për vendosjen e Çmimeve.....	5
B.	Metodologjia e Tarifave	5
III.	Të Hyrat e Lejuara Maksimale	6
A.	Totali i HLM	6
a)	Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (OMPC)	8
b)	Amortizimi i Lejuar (DEPC).....	8
c)	Të Hyrat e Lejuara në Kapital (RTNC)	8
d)	Kostoja e Humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes (LSSC)	9
e)	Çështje të tjera për t'u përfshirë të HLM	10
IV.	Alokimi i HLM dhe përcaktimi i tarifave për SHSSH	10
V.	Tarifat e propozuara	11

Shtojca A: Metodologjia për Tarifa të SHSSH

I. Hyrje

A. Përmbledhje

Ky aplikacion i dorëzohet Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës për miratimin e tarifave të rregulluara të propozuara për operimet e sistemit të shpërndarjes, të cilat janë të licencuara nga ZRRE-ja për KEK-un.

B. Bilanci Energjetik

Në mënyrë që të llogariten kostot e përgjithshme të shpërndarjes, pikënisjen duhet ta ofrojë Bilanci Energjetik. Bilanci energjetik përshkruan sasinë e energjisë, të matur në KWh (ose MWh) që pritet të futet në dhe dalë jashtë rrjetit të shpërndarjes. Tabela 1 ofron një përmbledhje të bilancit përfundimtarë të energjisë siç jemi pajtuar me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ZRRE dhe KOSTT-in .

Tabela 1- Përmbledhje e Bilancit Të Energjisë për vitin 2012

Linja	Hyrja/Dalja	Sasia
Nr.	Përshkrimi	GWH
1	Kosova A Gjenerimi Neto (Neto me të gjitha shpenzimet vetanake)	1,475.3
2	Kosova B Gjenerimi Neto (Neto me të gjitha shpenzimet vetanake)	3,392.5
3	Gjenerimi nga Ujmani	82.0
4	Importet	820.8
5	Totali në Sistemin e Transmisionit (1 + 2 +3 + a4)	5,770.6
6	Shitjet nga Transmisioni	744.6
7	Shfrytëzimi nga KEK-u	20.4
8	Minierat	111.0
9	Eksportet	169.8
10	Humbjet në Transmision	128.2
11	Teprica	13.3
12	Totali nga Transmisioni (6 + 7 + 8 + 9 + 10 + 11)	1,187.3
13	Neto në Sistemin e Shpërndarjes (5 - 12)	4,583.3
14	Gjeneratorët e kyçur në Sistemin e Shpërndarjes	51.5
15	Energjia e furnizuar nga KOSTT-i në Veri të Kosovës	203.7
16	Humbjet Teknike te Shpërndarjes	796.9
17	Humbjet Komerciale te Shpërndarjes	723.2
18	Neto për shitjet në Nivelin e Shpërndarjes (13 + 14 - 15 - 16-17)	2,911.0
19	Shitjet në Nivel të Shpërndarjes	
20	35 kV	40.1
21	10 kV	205.0
22	0.4 kV	2,665.8
23	Totali (20+21+22)	2,910.9

C. Definicionet

Nëse nuk shënohet ndryshe, përkufizimi i termave në këtë dokument është i njëjtë me ato definicione në ligjet e energjisë së Kosovës dhe me ato që janë të përfshira në Rregullat e Çmimeve të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

II. Rregullat e Çmimeve dhe Metodologjia e Tarifave

Ky seksion përshkruan se si ky Aplikim Tarifor është në përputhje me Rregullat e Çmimeve dhe Metodologjinë Tarifore të propozuar nga KEK-u dhe dërguar tek ZRRE-ja për aprovim.

A. Rregulla për Vendosjen e Çmimeve

Në nëntor 2011, ZRRE-ja miratoi " Rregulla e Çmimeve për Operatorin e Sistemit të Shpërndarja (Rregulla e Çmimeve OSSH)". Kjo Rregull zëvendëson rregullat e mëparshme "Rregullin mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve)" dhe "Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike", e cila ishte miratuar nga ZRRE-ja më 15 dhjetor 2005.

B. Metodologjia e Tarifave

Metodologjia për përcaktimin e tarifave të Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes (SHSSH) e ndjek metodologjinë e tarifave të propozuara nga KEK-u dhe është në përputhje me Rregullën Çmimeve për OSSH të ZRRE-së. Të Hyrat fillestare Maksimale të Lejuara (HLM) për periudhën e Parë Rregullative janë llogaritur në përputhje me Rregullën për Çmimet e OSSH-së. Çdo vit gjatë periudhës rregullative të HLM dhe tarifave që rezultojnë do të përcaktohen në përputhje me Metodologjinë e Tarifave të OSSH-së. Siç thuhet në Shtojcën 10 të Rregullës për Çmimet e OSSH-së, periudha e parë rregullative do të mbulojë vetëm një vit (1 prill 2012 deri 31 mars 2013), prandaj, dispozitat për disa vite të Rregullës, në këtë aplikim tarifor nuk duhet të trajtohen.

III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale

A. Totali i Të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM)

Sipas Rregullës së Çmimeve të OSSH-së, të hyrat e lejuara maksimale (HLM) janë zhvilluar në fillim të periudhës rregulative duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LSSC_t + LICC_t + KREV_t$$

Where

MAR_t eshte të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM)ne vitin relevant t

$OPMC_t$ kostot e lejuara per operim dhe mirembajtje ne vitin relevant t

$DEPC_t$ zhvleresimi i lejuar ne vitin relevant t

$RTNC_t$ kthimi i lejuar ne capital per vitin relevant t

$LSSC_t$ kostot e lejuara te humbjeve ne vitin relevant t

$LICC_t$ Ngarkesa per Licence ne vitin relevant t

$KREV_t$ faktori korrektues i te hyrave ne vitin relevant

Të hyrat e lejuara maksimale (HLM) të propozuara për vitin 2012 për OSSH janë të detajizuara në Tabelën 2.

Tabela 2- Te hyrat e Lejuara Maksimale të propozuara për OSSH për vitin 2012

Zhvillimi Tarifës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Vlera e Eurove në mijëra përvec vlerës së njësjive

Të gjitha kostot e bazuara në Vitin 2012

Komponentët e Kostos

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

O&M Rrjetit		14,640	
Alokimi i Kosotove te Administratës Qendrore		1,820	
TOTAL KOSTOT E O&M			16,460 =OPMC

Baza e Aseteve të Rregulluara për qëllime të zhvlerësimit:

Kostoja me 01 Jan 2012	160,800
shtesat e 2012	16,003
Kostoja me 31 Dhje 2012	176,803

Zhvlerësimi për Vitin 2012 **5,627 =DEPC**

Jetëgjatësia e asetëve me 2012	30
Zhvlerësimi Akumuluar me 01Jan12	70,113
Zhvlerësimi për vitin 2012	5,627
Zhvlerësimi Akumuluar me 31Dhje12	75,740

Grantet:

Grantet me 01 Jan 2012	28,326
Zhvlerësimi Granteve 2012	977
Grantet me 31 Dhje 2012	27,349

RABf për Kalkulim të Kthimit:

Fillimi Vitit	62,361	
Fundi Vitit	73,714	
Mesatarja për 2012		68,038

Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit për Rrjet 14.40%

Kthimi për 2012 **9,797 =RTNC**

Kostoja e Humbjeve

Humbjet Teknike sipas Bilan. të Energj.(MWH)	796,940	
Humbjet Komerciale sipas Bilan. të Energj.(MWH)	723,249	
Total humbjet e Sistemit të Shpërndarjes(MWH)	1,520,189	
Kostoja e Humbjeve (Energjia me Shumicë €/MWH)	38.65	
		58,755 = LSSC

Ngarkesa për Licensë të OSSH-së **0 = LICC**

Komponentët tjerë:

Azhustimet për nën-shpenzimet në shpenz. kapitale në 2011	(363)
Të hyrat nga palët e treta	(2,800)
Total kostot tjera	(3,163)

Total Kostoja për OSSH **87,476 =HLM**

Vlerat për komponentët e ndryshme të formulës Të Hyrat e Lejuara maksimale (HLM) në Shtojcën 1 të Rregulla e Çmimeve të OSSH-së janë përcaktuar si më poshtë:

a) Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (OMPC)

Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes për Rrjet në 2012 (14.600.000 €) janë ato të përfshira në buxhetin e KEK-ut për vitin 2012. Kjo është më e ulët se 16.700.000 € të aprovuara nga ZRRE-ja në shqyrtimin tarifor 2011, kryesisht për shkak të kontrollit më agresiv të kostove të materialeve dhe shërbimeve të ndërmarra nga KEK-u.

Alokimi i shpenzimeve të Zyrës Qendrore për Rrjetin (1.800.000 €) është pak më shumë se shumata e ZRRE-së e aprovuar në vitin 2011. Metoda e alokimit është e njëjtë si në shqyrtimet e mëparshme të tarifave.

b) Zhvlerësimi i Lejuar (DEPC)

Rregullat e reja të çmimeve kanë ripërcaktuar Bazën e Aseteve të Rregulluara për Asete dhe përfshijnë asetet para 2006 në RAB. Pjesa e I-r ë e Aplikacionit Tarifor të KEK-ut ka ofruar një dokumentim të RAB deri më 31 Dhjetor 2011. Duke e përdorur këtë si pikënisje, shtesat kapitale për 2012 prej € 16.0 milionë janë shtuar dhe zhvlerësimi për 2012 është bazuar në mesataren e bilancit të asetëve fikse dhe jetën 30 vjeçare të asetëve të rrjetit për të prodhuar një vlerë prej € 5.6 milionë Eurosh për zhvlerësim në vitin 2012.

c) Kthimi i Lejuar në Kapital (RTNC)

Informacionet e fund vitit 2011 të RAB dhe informacionet e MPKK në Pjesën I të aplikacionit tarifor ofrojnë pikë nisjen për RAB dhe llogaritjet e kthimit për 2012. Tabela 2 paraqet këtë informacion dhe përfshin veprimtarinë e pritshme për vitin 2012 (CAPEX, amortizimin, dhe zhvlerësimin e grantit) për të arritur në një RAB mesatare prej € 68.040.000 milionëve për llogaritjen e kthimit.

Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) llogaritet , në përputhje me Shtojcën 3 të Rregullit mbi Vendosijen e Çmimit të OSSH - si më poshtë:

$$WACC = (1 - g) * (rE) / (1 - t) + g * (rD)$$

Ku

WACC është Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit(MPKK)

g laverazhi (borxhi:borxhi + norma e ekuitetit)

<i>rE</i>	<i>kostoja reale e ekuitetit (shprehur si si %)</i>
<i>rD</i>	<i>kostoja reale e borxhit (shprehur si %)</i>
<i>t</i>	<i>norma e tatimit mbi korporatat ne Kosove</i>

Ashtu si dokumentohet në Pjesën I të Aplikacionit Tarifor të KEK-ut për vitin 2012, informacionet bazë në RAB dhe MPKK, vlerat e variablave të komponentit për Rrjetin janë si më poshtë:

$$G = \text{laverazhi (borxhi: borxhi + norma e ekuitetit)} = 0.00$$

$$rE = \text{kostoja reale e ekuitetit (shprehur si \%)} = 13.00\%$$

$$rD = \text{kostoja reale e borxhit (shprehur si \%)} - \text{Jo e aplikueshme}$$

$$t = \text{norma e tatimit mbi korporatat ne Kosove} = 10\%$$

Prandaj për Rrjetin rezulton që MPKK të jetë 14.4%

MPKK prej 14.4% kur zbatohet në mesataren e RAB-it prej € 68.040.000 milion prodhon një kthim të € 9.800.000 milion.

d) Kostoja e Humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes (LSSC)

Humbjet në shpërndarje të dokumentuara si në Bilancin e Energjisë 2012 janë :

Humbjet Teknike	796,940 MWH
Humbjet Komerçiale	723,249 MWH

Siç është diskutuar me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe ZRRE- në, humbjet komerciale të përfshira në Bilancin Energjetik për vitin 2012 janë 15.6% e hyrjeve në sistemin e shpërndarjes. KEK-u është pajtuar që shumica e energjisë së shpërndarë nga KOSTT-i në Veri të Kosovës si dhe Humbjet Komerçiale të mosë jenë më të larta se 20% në vitin 2012. Pasi që energjia e shpërndarë në veri është 4.4% prej hyrjes në distribucion, humbjet komerciale maksimale mundë të jenë 15.6%. Raporti "Shqyrtimi i Pavarur i Humbjeve në Shpërndarje në KEK për vitin 2010", ka dokumentuar se humbjet komerciale në vitin 2010 ishin 20% nga hyrjet në shpërndarje. KEK-u ka një objektiv për reduktimin e humbjeve komerciale për dy pikë përqindjeje për çdo vit. Kjo do të rezultojë që caku i humbjeve komerciale në vitin 2012 të jetë 16% që është shumë e përafërt me 15.6% të përfshira në bilancin e energjisë.

Aplikimi i Çmimeve me Shumicë të Energjisë (€ 38,65 / MWh) siç dokumentohet në Pjesën III të Aplikimit Tarifor të KEK-ut, Çmimi me Shumicë i Energjisë Elektrike për vitin 2012, rezultojnë në një kosto të humbjeve prej € 58.8 milion.

e) Çështje të tjera për t'u përfshirë të HLM

Të HLM për 2012 duhet të përfshijnë dy komponentë shtesë. Meqenëse KEK-u nuk e ka shpenzuar shumën totale të CAPEX të lejuara në tarifat për vitin 2011, një rregullim duhet të bëhen në vitin 2012 për të pasqyruar zhvlerësimin dhe kthimin në shumën e pashpenzuar. Përveç kësaj, HLM duhet të përshtatet nga të ardhurat e pritura nga palët e treta për përdorimin e objekteve të rrjetit të KEK-ut (€ 2.800.000 milion).

KEK-u rekomandon që ZRRE-ja të shqyrtojë dhe miratojë të HLM të propozuara për vitin 2012 për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes në vlerën prej € 87,476,000.

IV. Alokimi i HLM dhe përcaktimi i tarifave për SHSSH

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i rimëkëmb të HLM të saja përmes tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (SHSSH). Kjo është arritur duke alokuar çdo element të HLM në nivelet e tensionit siç është përshkruar në detaje në Shtojcën A.

Në përputhje me kapitullin IV, Ngarkesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të Rregullës së Çmimeve për OSSH: OSSH-ja kohë pas kohe do të caktojë Ngarkesat për SHSSH si të tilla që:

- OSSH i rimëkëmb të ardhurat e saja të lejuara të cilat nuk mbulohen nga ngarkesat e tjera ose nga Shërbimet e përjashtuara; dhe
- Ngarkesat e SHSSH janë në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga OSSH-ja dhe të miratuara nga Rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në përputhje me Deklaratën e Parimeve për Ngarkesën e Shpërndarjes të lëshuar nga Rregullatori.

OSSH-ja do t'i dorëzojë Rregullatorit metodologjinë e sajë për ngarkesat e SHSSH dhe të çdo ndryshimi të mëvonshëm të kësaj metodologjie të paktën 30 ditë pune para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.

Asnjë metodologji ose amendamente për një metodologji nuk do të jenë në fuqi derisa të miratohet nga Rregullatori.

OSSH-ja do të ketë të drejtë të përcaktojë ngarkesat e SHSSH duke u bazuar në kërkesat e mësipërme.

Me këtë rast KEK-u paraqet Metodologjinë për Ngarkesat e SHSSH në shtojcën A dhe kërkon nga ZRRE-ja që ta rishikoj dhe aprovoj.

Shtojca A poashtu i ofron ZRRE-së tarifat e propozuara për SHSSH që rrjedhin nga zbatimi i Metodologjisë për SHSSH të HLM për vitin 2012.

V. Tarifat e propozuara

Tarifat e propozuara për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3 – Tarifat e propozuara për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (SHSSH) për vitin 2012.

Niveli i Tensionit	€ cent/kWh
35 kV	1.01
10 kV	1.65
0.4 kV	3.14

KEK-u kërkon nga ZRRE-ja të miratojë tarifat e SHSSH të paraqitura në Tabelën 3.

SHTOJCA A

METODOLOGJIA E TARIFAVE TË SHFRYTËZIMIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE LLOGARITJAE ÇMIMEVE TË PROPOZUARA PËR SHSS

Ky dokument paraqet metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes (SHSSH) dhe i aplikon ato në kostot e vitit 2

Përmbledhja e Metodologjisë:

1. Pikënisja është tek Bilanci Vjetor i Energjisë si dhe Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH
2. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH janë alokuar në nivele të tensionit bazuar në energji dhe fuqi
3. Humbjet Teknike janë analizuar dhe alokuar në nivele të tensionit
4. Humbjet Komerciale janë analizuar dhe alokuar në nivele të tensionit
5. Tarifat e SHSSH-së sipas nivelit të tensionit janë kombinim i pikave të mësipërme 2,3 dhe 4.

Fleta e punës:

Përmbajtja

Kalkulimet Përmbledhëse	Përmbledhja e elementeve të kostos të cilat duhet të mbulohen në Tarifën e SHSSH-së sipas tensionit
Të Hyrat e Lejuara - Rrjet	Të Hyrat e Lejuara për Rrjet në vitin 2012 bazuar në kërkesën e të Hyrave të Lejuara
Humbjet Teknike sipas Tensionit	Alokimi i Hum. Tek. të Shpërn. sipas tensionit bazuar në rezultatet e realizuara dhe analizat e Div. të Rrjetit gjatë vitit 2011
Alokimi Humbjeve Komerciale	Humbjet Komerciale 2012 nga Bilanci i Energjisë i alokuar nëpër nivele të tensionit
Alokimi Energjisë dhe Fuqisë	Alokimi shitjeve të konsumatorëve 2012 nëpër nivele të tensionit dhe analizimi i kontribimit të pikut distributiv sipas niveleve të te

PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE:

Kostoja e Shfryt. të Sis. të Shpërn. për konsumatorët e kyçur në:

35 KV	1.01 Euro cent për kWh tw faturuar
10 KV	1.65 Euro cent për kWh tw faturuar
0.4 KV	3.14 Euro cent për kWh tw faturuar

Elementet e Kostos të cilat duhet të mbulohen përmes Tarifës së Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes
 Bazuar në të Hyrat e Lejuara të kërkuara për vitin 2012

	Total (€000)	Alokimi në Nivele të Tensionit (€000)		
		35KV	10KV	0.4KV
a) Të Hyrat e Lejuara për Rrjet				
Kostot në lidhje me Kapitalin (Zhvlerësimi dhe Kthimi)	15,424	112	815	14,498
<i>Alokimi bazuar në Fuqi</i>		0.72%	5.28%	93.99%
Kostot Operative	13,297	183	936	12,178
<i>Alokimi bazuar në energji</i>		1.38%	7.04%	91.58%
TOTAL TË HYRAT E LEJUARA	28,721	295	1,751	26,675
b) Humbjet Teknike:				
Energjia e Shpërndarë në Sistem të Shpërndarjes (MWH)	4,634,851			
% Energjisë së humbur në Sistem të Shpërndarjes	17.2%	0.10%	2.72%	97.18%
Humbjet Teknike në MWH	796,940	833	21,652	774,456
Çmimi Energjisë së shfrytëzuar për Humbje (€ për MWH)	38.65			
Kostoja e Humbjeve Teknike	30,802	32	837	29,933
c) Humbjet Jo-Teknike (Komerçiale):				
Energjia e Shpërndarë në Sistem të Shpërndarjes (MWH)	4,634,851			
% Energjisë së humbur në Sistem të Shpërndarjes	15.60%			
Humbjet në MWH	723,249	2,005	20,500	700,744
Çmimi Energjisë së shfrytëzuar për Humbje (€ për MWH)	38.65			
Kostoja për Humbje Jo-Teknike	27,954	77	792	27,084
TOTAL KOSTOT PËR TU MBULUAR NË TARIFAT E SHSSH-së	87,477	404	3,380	83,692
SHITJET (MWH)	2,910,941	40,100	205,000	2,665,841
TARIFA (Euro cent për kwh)	3.01	1.01	1.65	3.14

Komponentet e të Hyrave të Lejuara		2012
		Kërkesa
<u>Shpenzimet Operative</u>		
Derivate		60.0
Energjia		
Mirëmbajtja		4,915.0
Të tjera		805.0
Materialet dhe Shërbimet		840.0
Personeli		7,465.3
Sigurimi		360.0
Të tjera		194.5
Total OPEX(shpenzimet operative) vjetore		14,640
<u>Zhvlerësimi Vjetor</u>		5,626.7
<u>Taksat</u>		0.0
TOTAL SHPENZIMET VJETORE		20,266.5
<u>Kthimi Lejuar</u>		9,797.4
<u>Kostot e Alokua të AQ-së</u>		1,820.6
<u>Azhustimet për Shpenz. Kap.(CapEX) të nën-shpenzuara për vitin 2011</u>		(363.1)
<u>Të hyrat nga palët e treta</u>		(2,800.0)
Total të Hyrat e Lejuara		28,721.3

	110/35/10KV	35 KV	35/10 KV	10 KV	10/0.4 KV	0.4 KV	Rrjedha e		% Hum. Teknike	Energjia Faturuar			
	Transformatore	Linjat	Transformatore	Linjat	Transformatore	Sistemi	TOTAL	Ener. permes Shperndarjes		35KV	10 KV	0.4 KV	Total
Jan.11	2,269	6,413	2,035	34,860	6,651	52,727	104,955	574,759	18.3%	3,931	17,418	254,179	275,528
Feb.11	1,769	4,995	1,689	26,047	5,794	45,614	85,908	491,785	17.5%	3,489	16,783	237,844	258,116
Mar.11	1,754	4,199	1,636	25,479	5,918	44,495	83,481	486,079	17.2%	3,328	18,645	245,949	267,923
Apr.11	1,281	2,890	1,278	15,582	4,892	33,203	59,126	368,481	16.0%	2,654	16,374	210,653	229,680
May.11	1,072	2,449	1,256	13,859	4,711	31,782	55,129	352,054	15.7%	3,546	15,662	191,862	211,071
Jun.11	1,151	1,996	1,125	10,691	4,240	26,679	45,881	305,073	15.0%	3,210	15,266	194,720	213,196
Jul.11	1,226	2,166	1,112	11,905	4,522	29,007	49,937	331,147	15.1%	3,701	16,033	199,253	218,987
Aug.11	1,073	2,169	1,093	12,498	4,572	29,782	51,186	333,886	15.3%	3,594	16,403	209,004	229,000
Sep.11	994	2,663	1,182	10,954	4,439	26,670	46,903	305,627	15.3%	3,248	15,688	198,212	217,148
Oct.11	1,297	2,981	1,347	19,727	5,093	35,746	66,191	399,006	16.6%	3,634	17,211	211,545	232,390
Nov.11	1,646	3,366	1,503	25,962	5,694	41,298	79,468	465,643	17.1%	3,317	16,914	213,509	233,740
Dec.10	1,918	6,105	1,921	30,252	7,432	45,895	93,523	533,013	17.5%	3,321	17,692	247,366	268,379

Total	17,451	42,392	17,177	237,815	63,957	442,896	821,689	4,946,553	16.6%	40,973	200,090	2,614,096	2,855,159
								821,689		1.44%	7.01%	91.56%	100.00%
								796,940					
								3,327,924			200,090	2,614,096	2,814,186
											7.11%	92.89%	100.00%

Niveli Tensionit **Alokimi Humbjeve per vitin 2011**

35 KV	250	608	0				859	0.10%
10 KV	1,223	2,971	1,221	16,909			22,324	2.72%
0.4 KV	15,978	38,813	15,956	220,907	63,957	442,896	798,507	97.18%
	17,451	42,392	17,177	237,815	63,957	442,896	821,689	100.00%

Alokimi Humbjeve Komeriale të Shpërndarjes për vitin 2012

(Energjia në MWH)

Total Humbjet Komeriale **723,249** sipas Bilancit të Energjisë 2012

Humbjet e Alokua tek Konsumatorët e nivelit 35 KV:

Shitjet tek Kons. 35 KV sipas Bilancit të Energjisë	40,100	
Humbjet Komeriale të supozuara si % e Shitjeve	5.00%	
Alokimi Humbjeve Komeriale (MWH)		2,005

Humbjet e Alokua tek Konsumatorët e nivelit 10 KV :

Shitjet tek Kons. 10 KV sipas Bilancit të Energjisë	205,000	
Humbjet Komeriale të supozuara si % e Shitjeve	10%	
Alokimi Humbjeve Komeriale (MWH)		20,500

Humbjet e Alokua tek Konsumatorët e nivelit 0.4 KV :

I barabartë me total humbjet komerciale minus alokimet në nivel 35 dhe 10 KV		700,744
Shitjet tek konsumatorët 0.4 KV sipas Bil. të Energj.	2,665,841	
Humbjet Komeriale rezultuese si % e Shitjeve	26%	

SHËNIM: Përqindjet e supozuara të humbjeve komerciale për konsumatorët e 35 dhe 10 KV janë të bazuara në paragjykim

Alokimet tek Shitjet dhe Fuqia

Grupi Tarifor	Shitjet (MWH)	Alokimi Energjisë	Alokimi Fuqisë
	(a)	(b)	(c)
35kv	40,100	1.38%	0.72%
10kv	205,000	7.04%	5.28%
0.4kv	2,665,841	91.58%	93.99%
	2,910,941	100.0%	100.0%

- Burimi:
- (a) Shitjet sipas nivelit të tensionit bazuar në Bilancin Përfundimtar të Energjisë 2012
 - (b) Përqindja e Alokimit të Energjisë bazuar në shitjet në kolonën e mëparshme
 - (c) Alokimi Fuqisë nga analizat e mëposhtme - Kontribimi në piquet e pesë muajve të Sistemit të Shpërndarjes

Analiza e Fuqisë

Periudha Analizimit: 12 Muaj me përfundim në Nentor 2011
Vlerat e Fuqisë në MW

Pesë muajt maksimal të pikut:	JAN '11	SHKU '11	MAR '11	NEN' 11	DHJE '10
Fuqia Mak.e Sis. te Shpern.	972	953	901	928	948
minus:35kV fuqia e faturuar	7	7	7	6	7
minus: 10kV fuqia e faturuar	<u>46</u>	<u>50</u>	<u>53</u>	<u>48</u>	<u>51</u>
= 0.4kV fuqia e vlerësuar	919	896	841	874	890

Kontribimi në Pik

35kV	0.72%	0.73%	0.78%	0.65%	0.74%	0.72%
10kV	4.73%	5.25%	5.88%	5.17%	5.38%	5.28%
0.4kV	94.55%	94.02%	93.34%	94.18%	93.88%	93.99%
TOTAL	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

Mesatarja 5 mujore

12 janar, 2012